

Newsletter

Autoriteti i Konkurrencës gjatë muajve Prill-Qershor 2024 ka marrë 19 vendime:

- **Abuzim me pozitën dominuese:** 1 vendim;
- **Marrëveshje të ndaluara:** 2 vendime;
- **Përqendrime:** 8 vendime;
- **Rekomandime:** 2 vendime;
- **Gjoha:** 2 vendime;
- **Kushte dhe detyrime:** 1 vendim;
- **Vendime të tjera:** 3 vendime.



Ndër vendimet më të rëndësishme mund të përmendim:

1

Marrëveshje e ndaluar

Vendoset nën hetim paraprak tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë i fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

Komisioni i Konkurrencës, pas përfundimit të procedurës së monitorimit në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve mori në shqyrtim në mbledhjen e datës 14.06.2024 propozimin e sekretariatit të konkurrencës për hapjen e hetimit paraprak në këtë treg për qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

Referuar strukturës së tregut, integritetit vertikal, sjelljes së ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri tek konsumatori fundor, mund të jemi para një sjelljeje antikonkurruese si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, me **vendimin nr. 1085, datë 14.06.2024**, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore nga 1 Janar 2023 deri në 31 Maj 2024.

2

Abuzim me pozitën dominuese

Hapja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.

Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim rastin e hapjes së procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me vendimin nr. 1025, datë 18.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit”, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 13 tetor 2023.

Në zbatim të këtij vendimi, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet e administrimit dhe nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e aksesit të internetit.

Në përfundim të analizës së informacioneve dhe të dhënave të siguruara, pasi rezultoi se:

- 1.ekzistojnë problematika për kufizimin e aksesit nga ndërmarrje të tjera të administrimit në rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës;
- 2.disa nga ndërmarrjet e administrimit kanë aksionarë të përbashkët me ndërmarrjet e internetit, dhe ushtrojnë veprimtarinë në të njëjtën rezidencë banimi, duke sjellë kështu një integrim vertikal, ngrihen dyshime që në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit mund të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003;
- 3.në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e ndërmarrjeve të administrimit mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë këtë shërbim; duke zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët dhe duke krijuar kushtet e favorshme për krijimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve të internetit brenda rezidencës që ata administrojnë;

Komisioni i Konkurrencës me **vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024**, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë. Hetimi i thelluar përfshin periudhën kohore nga 1 Janar 2020 deri në 10 Maj 2024.

3 Përqendrim

Rasti i njoftimit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfutimit të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD.

Komisioni i Konkurrencës, mori në shqyrtim rastin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfutimit të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD.

Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1088, datë 21.06.2024, vendosi të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfutimit të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD.



Aktivitete



Në kuadër të forcimit të kapaciteteve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës, me asistencën e Taixex (Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit të Komisionit Evropian), në bashkëpunim me Zyrën Polake të Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, u zhvillua në datat 7-8 maj 2024, Workshop-i mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës dhe advokacisë.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm tre përfaqësues të Zyrës Polake të Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Znj. Marta Michalak, Z. Jan Ulański dhe Z. Antoni Napieralski, të cilët kanë një eksperiencë shumëvjeçare në fushën e konkurrencës.


Ky Workshop ka si qëllim përvetësimin e përvojës polake dhe shkëmbimin e eksperiencave në procedurat antitrust dhe sfidat e reja për autoritetin e konkurrencës në përballjet me tregjet ekzistuese, ato sensitive dhe tregjet e reja.

Workshop-e të tilla do të vazhdojnë të zhvillohen përgjatë vitit 2024 dhe më tej si mision i AK për trajnimin e vazhdueshëm të stafit, qasjen me përvojat e Bashkimit Evropian, drejt përmirësimit dhe azhurnimit të praktikave të punës në fushën e konkurrencës dhe politikave që zbatohen në funksion të saj.





Aktivitete



Në kuadër të promovimit të mëtejshëm të kulturës së konkurrencës me botën akademike, në datën 15 Maj 2024, në ambientet e Universitetit “Epoka”, me bashkëpunimin e Autoritetit të Konkurrencës dhe Departamentit të Drejtësisë së Universitetit “Epoka”, u zhvillua konferenca e parë studentore me temë “Konkurrenca, tregu dhe teknologjia”.

Në këtë konferencë morën pjesë Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, z. Denar Biba, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, Dekani i Universitetit “Epoka”, z. Lisen Bashkurti, Rektori, z. Ahmet Oztas dhe profesorë e studentë të departamentit të drejtësisë së këtij universiteti.

Autoriteti i Konkurrencës nxiti organizimin dhe kthimin në traditë të konferencave të tilla si një nga mënyrat më të mira për promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës, përmes intensifikimit të marrëdhënieve me botën akademike.

Më datë 16 maj 2024, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, z. Denar Biba, mirëpriti në një vizitë zyrtare në ambientet e Autoritetit të Konkurrencës një përfaqësi të Autoritetit Turk të Konkurrencës.

Gjatë kësaj vizite u shkëmbyen ide dhe mendime për praktikën më të mira të dy institucioneve duke e vënë theksin sidomos tek nevoja për bashkëpunim të dyanshëm, shkëmbimi i eksperiencës midis dy institucioneve si dhe mundësia e trainimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës.

Në përfundim të takimit, nga ana e delegacionit të Autoritetit Turk të Konkurrencës u ftuan Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës z. Biba si dhe z. Eduard Shalsi të jenë pjesë e konferencës mbi konkurrencën e cila do të zhvillohet në Stamboll, Turqi në datat 30 Shtator – 2 Tetor 2024.

